FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Nr.166 29 tetor 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1338, datë 10.10.2008	Për hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë "Inxhinieri agrare-agromekanizim", në Fakultetin e Bujqësisë dhe të Mjedisit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës, dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit për këtë program, në vitin akademik 2008-2009 ……	8177
Vendim i KM nr.1350, datë 3.10.2008	Për miratimin e raportit për gjendjen e mjedisit në Shqipëri, për vitet 2005, 2006 e 2007 ……	8177
Vendim i KM nr.1353, datë 10.10.2008	Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor ……	8178
Vendim i KM nr.1370, datë 10.10.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë në mësuesi, dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe studimi, në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, në vitin akademik 2008-2009 ……	8180
Vendim i KM nr.1371, datë 10.10.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe, në universitetin "Fan.S.Noli", Korçë, në vitin akademik 2008-2009	8181

Vendim i KM nr.1372, datë 10.10.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe, në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, në vitin akademik 2008-2009 ……	8182
Vendim i KM nr.1373, datë 10.10.2008	Për hapjen e programit të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këtë program, në Universitetin e Tiranës, në vitin akademik 2008-2009 ……	8183
Vendim i KM nr.1374, datë 10.10.2008	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor	8183
Vendim i KM nr.1375, datë 10.10.2008	Për hapjen e programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit e të tarifës së shkollimit në këto programe, në universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në vitin akademik 2008-2009……	8185
Vendim i KM nr.1383, datë 17.10.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bicaj, të qarkut të Kukësit …….	8186
Vendim i KM nr.1384, datë 17.10.2008	Për një shtesë në vendimin nr.589, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave "Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve më të rëndësishme shtetërore", të ndryshuar ……	8188
Vendim i KM nr.1387, datë 17.10.2008	Për një ndryshim në vendimin nr.532, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave "Për lejet e transportit të mallrave për transportuesit, që nuk kanë seli në Shqipëri" ……	8188
Vendim i KM nr.1388, datë 17.10.2008	Për lejimin e kalimit transit të disa autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë ……	8189
Vendim i KM nr.1389, datë 17.10.2008	Për lejimin e kalimit transit të disa autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë …….	8190
Vendim i KM nr.1390, datë 17.10.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Vorë-Fushë-Krujë ……	8191
Vendim i KM nr.1392, datë 17.10.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i mbingritjes në rrugën Virua-Gjirokastër ……	8193
Vendim i KM nr.1393, datë 17.10.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i shkollës së mesme dhe të konviktit, në qytetin e Peshkopisë, Dibër ……	8196

Vendim i KM nr.1395, datë 17.10.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të shoqërive "Titan" sh.p.k. dhe "Osmani" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2" …….	8197
Vendim i KM nr.1396, datë 17.10.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë "Atlas" sh.a., për ndërtimin e hidrocentraleve "Holta Kabash" dhe "Holta Poroçan" ……	8197
Vendim i KM nr.1398, datë 17.10.2008	Për faljen e detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe të taksës së regjistrimit të përvitshëm të tyre ……	8198
Kërkesë e MPPTT nr.3547/1, datë 3.9.2008	Për shpronësim, për pasuritë që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Rrëshen-Prosek. ……	8199
Kërkesë e MPPTT nr.3742/1, datë 17.10.2008	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Laç-Kisha Shënanout" ……	8201
Kërkesë e MPPTT nr.6302/1, datë 17.10.2008	Për shtesë shpronësimi, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan – Vlorë.……	8202
Kërkesë e MPPTT nr.6302/2, datë 17.10.2008	Për korrigjim të vendimit nr.207, datë 21.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësim për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i dytë)" dhe vendimit nr.269, datë 5.3.2008 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan -Vlorë (seksioni i parë)".……	8208

VENDIM
Nr.1338, datë 10.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË PARË "INXHINIERI AGRARE – AGROMEKANIZIM", NË FAKULTETIN E BUJQËSISË DHE TË MJEDISIT, TË UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, DHE PËR MIRATIMIN E KUOTËS SË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTË PROGRAM, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25, 26, 33 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë "Inxhinieri agrare-agromekanizim", në Fakultetin e Bujqësisë dhe të Mjedisit, të Universitetit Bujqësor të Tiranës, dhe për miratimin e kuotës së pranimit e të tarifës së shkollimit për këtë program, në vitin akademik 2008-2009. Në përfundim të studimeve të ciklit të parë përfitohet diplomë e nivelit të parë, DNP, në degën inxhinieri agrare-agromekanizim.
2. Tarifa vjetore e shkollimit, për studentët që regjistrohen në vitin e parë, në këtë program studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, të jetë 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, sipas vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009".
3. Programi i studimit të ciklit të parë realizohet me 180 kredite dhe zgjatja normale e tij është tri vite akademike.
4. Numri i kuotave të pranimit me kohë të plotë të jetë 25.
5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Bujqësor të Tiranës.
6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe rektori i Universitetit Bujqësor të Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1350, datë 3.10.2008

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËR GJENDJEN E MJEDISIT NË SHQIPËRI, PËR VITET 2005, 2006 E 2007

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 69 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit për gjendjen e mjedisit në Shqipëri, për vitet 2005, 2006 e 2007, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1353, datë 10.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR PARAQITJEN E KËRKESËS, MBAJTJEN DHE PLOTËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK, SI DHE TË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE TË ZVOGËLIMIT TË SIPËRFAQES E TË VËLLIMIT TË FONDIT PYJOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat, fizikë ose juridikë apo organet e qeverisjes vendore, për pyjet komunale, e paraqesin kërkesën për heqjen e një sipërfaqeje nga fondi pyjor në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

2. Kërkesa bëhet me shkrim dhe përmban gjenealitetet e kërkuesit dhe të subjektit, që ai përfaqëson, një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë, që do të ushtrojë dhe investimet, që do të bëhen.

3. Kërkesa për heqjen e sipërfaqeve nga fondi pyjor është e vlefshme vetëm kur bëhet për veprimtaritë e përcaktuara shprehimisht në nenin 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar.

4. Personat, fizikë ose juridikë apo organet e qeverisjes vendore, për pyjet komunale, e paraqesin kërkesën në ministri, vetëm pasi kanë siguruar lejen, licencën ose dokumentin, që miraton ushtrimin e veprimtarisë, të lëshuar nga organi i ngarkuar me ligj për dhënien e miratimit.

5. Kërkesa shoqërohet me këto dokumente:

a) Njoftimin e ministrisë nga organi shtetëror, që ka miratuar veprimtarinë, ku sqarohet se, për nevoja të ushtrimit të veprimtarisë të miratuar prej tij, sipërfaqja e kërkuar të hiqet nga fondi pyjor;

b) Kopjen e noterizuar të lejes apo të dokumentit, me të cilin i është miratuar veprimtaria nga institucioni i ngarkuar me ligj;

c) Planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartën topografike të dixhitalizuar dhe të gjeoreferuar, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si dhe kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe çdo planimetri tjetër, në shkallë më të hollësishme, hartuar në përputhje me kërkesat e studimit apo të projektit.

6. Ministria mund t'ia kthejë kërkuesit dokumentacionin teknik, të paraqitur, për plotësime e saktësime. Koha për plotësimin e dokumentacionit nuk llogaritet në afatin e përcaktuar për shqyrtimin e kërkesës, i cili është një muaj.

7. Pas depozitimit të kërkesës, ministria i kërkon drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor të identifikojë ngastrat dhe nënngastrat e kërkuara dhe të hartojë raportin teknik për to, brenda 1 jave. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 ditëve nga data që ajo e ka kërkuar. Kur heqja kërkohet nga fondi pyjor komunal, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor e harton raportin teknik, në bashkëpunim me njësinë tekniko-administrative të pyjeve e kullotave, të njësisë së qeverisjes vendore.

8. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të mësipërm:

a) ministri nxjerr urdhrin për heqjen nga fondi pyjor, për pyje dhe toka, me bimësi pyjore, me sipërfaqe deri në 1 ha;

b) ministria përgatit projektvendimin për heqjen nga fondi pyjor, për pyje dhe toka, me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 1 ha e deri në 100 ha dhe e dërgon atë, për shqyrtim e miratim, në Këshillin e Ministrave;

c) ministria përgatit projektligjin për heqjen nga fondi pyjor, për pyje e toka, me bimësi pyjore, me sipërfaqe mbi 100 ha dhe e dërgon atë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, i cili, kur e gjen të rregullt, e përcjell në Kuvend, për miratim.

Praktikat e projektvendimit e të projektligjit nënshkruhen nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe nga ministri, që ka miratuar veprimtarinë.

9. Pas miratimit të heqjes së sipërfaqes nga fondi pyjor:

a) drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor bën përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe

dhe në vëllim dhe të dhënat i përcjell në ministri;

b) ministria bën përditësimin në Kadastrën Kombëtare të Pyjeve;

c) zyra përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme bën çregjistrimin e saj nga kategoria "Tokë e zënë, pyll" dhe e regjistron në kategorinë e re të përdorimit.

10. Sipërfaqja, që hiqet nga fondi pyjor publik, sipas këtij vendimi, kalon në një destinacion tjetër përdorimi, por, në çdo rast, mbetet në pronësi publike.

11. Vlera e sipërfaqes pyjore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhen nga kërkuesi para se akti i miratimit, të përmendur në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 8 të këtij vendimi, të hyjë në fuqi, dhe derdhet në llogarinë bankare të ministrisë, ndërsa për pyjet komunale, derdhet në llogarinë bankare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

12. Në rastet e ndërtimit të infrastrukturave lineare, si rrugë, linja të transmetimit ajror apo nëntokësor të energjisë elektrike, të naftës, gazit, telekomunikacionit, si dhe teleferikët, të cilat, në përputhje me projektet e miratuara, kërkojnë një trase të pastruar nga vegjetacioni, me gjerësi më të vogël se 10 m, për efekt kadastral, bëhet vetëm zvogëlim në vëllim, por jo në sipërfaqe.

13. Për shërbimin e ofruar nga ministria, sipas këtij vendimi, kërkuesi paguan një tarifë shërbimi, në vlerën 20 000 lekë, e cila derdhet në llogarinë bankare të ministrisë, në kohën e paraqitjes së kërkesës. Kjo tarifë është e pakthyeshme edhe nëse kërkesa nuk miratohet.

14. Kur kërkesën për ndryshimin e destinaiconit të një pjese apo të të gjithë pyllit a sipërfaqes pyjore, e bën pronari privat që e ka në pronësi, kërkesa sqaron:

a) sipërfaqen, që do t'i ndryshohet destinacioni;

b) veprimtarinë për çfarë do të përdoret (veprimtarinë që do të ushtrohet apo objektin që do të ndërtohet në të).

15. Kërkesa shoqërohet me këto dokumente:

a) Kopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë së pyllit apo sipërfaqes pyjore;

b) Studimin apo projektin e veprimtarisë që do të ushtrohet, apo të veprës që do të ndërtohet;

c) Kopjen e noterizuar të licencës, që ka miratuar veprimtarinë apo ndërtimin e objektit;

ç) Planimetrinë e sipërfaqes, që kërkohet të ndërrojë destinacion, në hartën topografike, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe kufijtë e pyllit apo të sipërfaqes pyjore, që mbetet pas miratimit të kërkesës;

d) Mandatpagesën e tarifës së shërbimit, sipas pikës 14 të këtij vendimi.

16. Kërkesa shqyrtohet nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor brenda 30 ditëve. Pas këtij afati ajo quhet e miratuar. Drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor dhe ministria bëjnë përditësimet në kadastrën e pyjeve.

17. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1370, datë 10.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË DHE MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI, NË UNIVERSITETIN "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të

Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, në Fakultetin Ekonomik, të programit të studimit të ciklit të dytë "Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në menaxhim i turizmit të qëndrueshëm.

2. Programi i studimeve i ciklit të dytë do të realizohet me 120 kredite dhe zgjatja normale e tij është dy vite.

3. Kuota e pranimeve në programin e studimit të ciklit të dytë "Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm", në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për vitin akademik 2008-2009, të jetë 60.

4. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 6/c/iv të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009".

5. Hapjen, në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, të programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, si më poshtë vijon:

a) Në lëndën "Biologji", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën biologji;

b) Në lëndën "Kimi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën kimi;

c) Në lëndët "Gjuhë-letërsi", në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm në lëndët gjuhë-letërsi.

6. Kuota e pranimeve në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, në universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për vitin akademik 2008-2009, të jetë si më poshtë:

- Në lëndën biologji 40;
- Në lëndën kimi 40;
- Në lëndët gjuhë-letërsi 40.

7. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në këto dy programe studimi, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 7/b/ii të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009".

8. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Luigj Gurakuqi", Shkodër.

10. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1371, datë 10.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME, NË

UNIVERSITETIN "FAN.S.NOLI", KORÇË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin "Fan.S.Noli", Korçë, në Fakultetin e Mësuesisë, të programeve të mëposhtme, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm:

a) Në lëndët "Gjuhë-letërsi", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndët gjuhë-letërsi;

b) Në lëndët "Shkenca sociale", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndët shkenca sociale.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, në universitetin "Fan S.Noli", Korçë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë si më poshtë vijon:

a) Në lëndët gjuhë-letërsi 40;

b) Në lëndët shkenca sociale 30.

4. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në këto dy programe studimi, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 7/b/ii të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009".

5. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Fan.S.Noli", Korçë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Fan.S.Noli", Korçë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1372, datë 10.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, në Fakultetin e Mësuesisë, të programeve të mëposhtme, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm:

a) Në lëndën "Matematikë", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën matematikë;

b) Në lëndën "Informatikë", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndën informatikë.

2. Programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë si më poshtë vijon:

a) Në lëndën matematikë 30;

b) Në lëndën informatikë 30.

4. Kuota e pranimeve në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, në universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, për vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 7/b/i të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009".

5. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1373, datë 10.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR ARSIMIN E MESËM, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTË PROGRAM, NË UNIVERSITETIN E TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 dhe 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave Sociale, të programit të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndët shkenca sociale, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndët shkenca-sociale.

2. Programi i studimit master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, realizohet me

60 kredite dhe zgjatja normale e tij është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programin, master i nivelit të parë në mësuesi, për arsimin e mesëm, në lëndët "Shkenca sociale", në Universitetin e Tiranës, për vitin akademik 2008-2009, të jetë 50.

4. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në vitin akademik 2008-2009, do të jetë sipas pikës 7/b/ii të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë cikli i dytë i studimeve dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009".

5. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin e Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1374, datë 10.10.2008

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE, QË NDIQEN PËR HEQJEN, SHTIMIN DHE NDRYSHIMIN E DESTINACIONIT TË FONDIT KULLOSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 10 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kuptim të këtij vendimi, me termat e mëposhtëm do të nënkuptohen:

a) "Heqje", veprimin e çregjistrimit të një sipërfaqeje kullote ose livadhi nga Regjistri i Fondit Kullosor, pas miratimit nga organet përgjegjëse;

b) "Shtim", veprimin e regjistrimit të një sipërfaqeje kullote ose livadhi në Regjistrin e Fondit Kullosor, me prejardhje nga kategori të tjera tokash, pas miratimit nga organet përgjegjëse;

c) "Ndryshim destinacioni", veprimin që pasqyron ndryshimin në Regjistrin e Fondit Kullosor, për kalimin nga një kategori përdorimi në tjetrën.

2. Personat, fizikë ose juridikë apo organet e qeverisjes vendore, për kullotat e livadhet komunale, paraqesin në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimi të Ujërave kërkesën për heqjen e sipërfaqes nga fondi kullosor.

3. Kërkesa për heqjen e sipërfaqeve nga fondi kullosor është e vlefshme vetëm kur bëhet për veprimtaritë e përcaktuara në nenin 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, dhe që janë në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor".

4. Personat, fizikë ose juridikë apo organet e qeverisjes vendore, për kullotat e livadhet komunale, e paraqesin kërkesën te ministri vetëm pasi kanë siguruar lejen, licencën ose dokumentin, të lëshuar nga organi i ngarkuar me ligj për miratimin e veprimtarisë.

5. Kërkesa bëhet me shkrim dhe përmban gjenealitetet e kërkuesit dhe të subjektit që ai përfaqëson, një përshkrim të shkurtër të veprimtarisë që do të ushtrojë, investimet që do të bëjë dhe kohëzgjatjen e zbatimit të projektit.

6. Kërkesa shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) Njoftimin e ministrisë nga organi shtetëror që ka miratuar veprimtarinë, ku sqarohet se për nevoja të ushtrimit të veprimtarisë së miratuar prej tij, sipërfaqja e kërkuar të hiqet nga fondi kullosor;

b) Kopje të noterizuar të lejes apo të dokumentit, me të cilin i është miratuar veprimtaria, nga institucioni i ngarkuar me ligj;

c) Planimetrinë e sipërfaqes së kërkuar në hartën topografike të dixhitalizuar dhe të gjeoreferuar, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si kufijtë natyrorë, relievi, objektet, si dhe çdo planimetri tjetër, në shkallë më të hollësishme, hartuar në përputhje me kërkesat e studimit apo të projektit.

7. Ministria, pas depozitimit të kërkesës, i kërkon drejtorisë përkatëse të shërbimit pyjor identifikimin e ngastrave dhe të nënngastrave të kërkuara dhe hartimin e raportit teknik për to, brenda 1 jave. Ky raport i përcillet ministrisë brenda 10 ditëve nga data që ajo e ka kërkuar. Kur heqja kërkohet nga fondi kullosor komunal, drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor harton raportin teknik, në bashkëpunim me njësinë tekniko-administrative të pyjeve e kullotave të njësisë së qeverisjes vendore.

8. Ministria mund t'ia kthejë personit, fizik ose juridik, dokumentacionin e paraqitur për plotësime e saktësime. Koha për plotësimin e dokumentacionit nuk llogaritet në afatin e përcaktuar për shqyrtimin e kërkesës, i cili është një muaj.

9. Në bazë të dokumentacionit të mësipërm:

a) ministri nxjerr urdhrin për heqjen nga fondi kullosor, për sipërfaqe deri në 1 ha;

b) ministria përgatit projektvendimin për heqjen nga fondi kullosor, për sipërfaqe mbi 1 ha, dhe e dërgon atë, për shqyrtim e miratim, në Këshillin e Ministrave.

10. Pas miratimit të heqjes së sipërfaqes nga fondi kullosor:

a) drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor bën përditësimin në regjistrimin e kullotave, që ajo administron, dhe të dhënat i përcjell në ministri;

b) ministria bën përdirësimin në Regjistrin Kombëtar të Kullotave;

c) zyra përkatëse e regjistrimit të pasurive të paluajtshme bën transferimin e regjistrimit nga kategoria "Tokë e zënë me kullotë apo livadh" në kategorinë përkatëse të përdorimit.

11. Sipërfaqja, që hiqet nga fondi kullosor publik, në përputhje me këtë vendim, ndryshon destinacionin e përdorimit, por, në çdo rast, mbetet në pronësi publike.

12. Vlera e sipërfaqes kullosore të hequr dhe e infrastrukturës së saj paguhet nga kërkuesi para hyrjes në fuqi të aktit të miratimit, të përmendur në shkronjat "a" e "b" të pikës 8 të këtij vendimi dhe derdhet në llogarinë bankare të ministrisë, ndërsa për kullotat komunale derdhet në llogarinë bankare të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

13. Kërkuesi, për shërbimin e kryer nga ministria, paguan një tarifë shërbimi, në vlerën 20 000 lekë, në llogarinë bankare të ministrisë, në kohën e paraqitjes së kërkesës. Kjo vlerë nuk kthehet edhe nëse kërkesa nuk miratohet.

14. Shtimi i sipërfaqes së fondit kullosor bëhet në rastet e ndryshimit të kategorive të përdorimit të tokës nga tokë pyjore, tokë e pafrytshme ose formime nga deltinat e reja të lumenjve, në kullotë apo livadh.

15. Nëse kërkesën për t'i ndryshuar destinacionin një pjese apo të gjithë kullotës a livadhit, që ka në pronësi, e bën pronari privat, në kërkesë përcaktohen:

a) edhe sipërfaqja, që do t'i ndryshohet destinacioni;

b) edhe veprimtaria për çfarë do të përdoret (veprimtaria, që do ushtrohet, apo objekti, që do të ndërtohet në të).

16. Kërkesa shoqërohet me këto dokumente:

a) Kopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë së kullotës apo livadhit;

b) Studimin apo projektin e veprimtarisë që do të ushtrohet, apo të veprës që do të ndërtohet;

c) Kopjen e noterizuar të licencës, që ka miratuar veprimtarinë apo ndërtimin e objektit;

ç) Planimetrinë e sipërfaqes, që kërkohet t'i ndërrohet destinacioni, në hartë topografike, në shkallën 1:10 000, ku të jenë evidentuar kufijtë natyrorë, relievi, objektet dhe kufijtë e kullotës, që mbetet pas miratimin të kërkesës;

d) Mandatpagesën e tarifës së shërbimit, sipas pikës 14 të këtij vendimi.

17. Kërkesa shqyrtohet nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor brenda 30 ditëve nga data e parqitjes. Me kalimin e këtij afati, kërkesa quhet e miratuar. Drejtoria e shërbimit pyjor dhe ministria bëjnë përditësimet në regjistrat e kullotave.

18. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1375, datë 10.10.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, MASTER I NIVELIT TË PARË NË MËSUESI, PËR CIKLIN E LARTË TË ARSIMIT BAZË, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT E TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME, NË UNIVERSITETIN "EQEREM ÇABEJ", GJIROKASTËR, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër, në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, të programeve të studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, si më poshtë vijon:

a) Në lëndët "Biologji-kimi", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë, master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët biologji-kimi;

b) Në lëndët "Matematikë-informatikë", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë-informatikë;

c) Në lëndët "Matematikë-fizikë", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndët matematikë-fizikë;

ç) Në lëndën "Gjuhë angleze", në përfundim të të cilit do të lëshohet diplomë master i nivelit të parë, MNP, në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në lëndën gjuhë angleze.

2. Programet e studimeve, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, realizohen me 60 kredite dhe zgjatja normale e tyre është një vit.

3. Kuota e pranimeve në programet e studimit, master i nivelit të parë në mësuesi, për ciklin e lartë të arsimit bazë, në universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër, për vitin akademik 2008-2009, të jetë si më poshtë vijon:

a) Në lëndët biologji-kimi 40;
b) Në lëndët matematikë-informatikë 60;
c) Në lëndët matematikë-fizikë 60;
ç) Në lëndën gjuhë angleze 50.

4. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen në vitin e parë, në këto programe studimi, në vitin akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 7/b të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si edhe tarifat e shkollimit për programet e studimit, të miratuara për vitin akademik 2008-2009".

5. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për universitetin "Eqerem Çabej", Gjirokastër.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastër, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1383, datë 17.10.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS BICAJ, TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bicaj, të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Bicaj, të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.508, datë 19.7.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bicaj, të qarkut të Kukësit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Bicaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Bicaj — Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji transferimit**
1-14	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
51,52	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administrative	Në pronësi
15-22	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
23-27, 29-30	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
31-50	Varreza publike	Në pronësi
54-148	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
149,150,153,157,158,161,162, 165,166,167,170,171,174,175, 177-179,182,183,186-188	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
151,152,155,156,159,160, 163,164,168,169,172,173, 176,180,181,184,185,189, 190,191	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
154	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

VENDIM
Nr.1384, datë 17.10.2008

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.589, DATË 5.9.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "dh" të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.589, datë 5.9.2007 të Këshillit të Ministrave, pas numrit rendor 12 shtohet numri 13, me këtë përmbajtje:

"13. Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, institucion në varësi të Ministrisë së Brendshme, që do të ruhet dhe sigurohet nga Policia e Shtetit deri më 31.10.2009.".

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1387, datë 17.10.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.532, DATË 21.8.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR LEJET E TRANSPORTIT TË MALLRAVE PËR TRANSPORTUESIT, QË NUK KANË SELI NË SHQIPËRI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 "Për transportet rrugore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.532, datë 21.8.1998 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Kontrolli i lejeve të transportit ndërkombëtar të mallrave për çdo kamion bëhet nga organet doganore të policisë kufitare dhe nga organet e kontrollit shtetëror të specializuar, pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në fillim të çdo viti ose rast pas rasti, njofton organet e mësipërme për llojet dhe sasinë e lejeve të transportit ndërkombëtar të mallrave, që shkëmbehen me çdo shtet, si dhe shtetet, kamionët e të cilave përjashtohen nga lejet e transportit ndërkombëtar të mallrave.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1388, datë 17.10.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE SLLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të 2 (dy) autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 27 tetor 2008, të përbëra nga:

a) Autokolona e parë, 1 (një) automjet dhe 6 trupa. Itinerari i lëvizjes, Qafë-Thanë - Porti i Durrësit.

b) Autokolona e dytë, 3 (tri) automjete dhe 8 (tetë) trupa. Itinerari i lëvizjes, Porti i Durrësit - Qafë-Thanë.

2. Lejimin e kalimit transit të 2 (dy) autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 30 tetor 2008, të përbëra nga:

a) Autokolona e parë, 4 (katër) automjete dhe 14 (katërmbëdhjetë) trupa. Itinerari i lëvizjes Qafë-Thanë - Porti i Durrësit.

b) Autokolona e dytë, 1 (një) automjet dhe 6 (gjashtë) trupa. Itinerari i lëvizjes, Porti i Durrësit - Qafë-Thanë.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 27 tetor 2008, për autokolonën e parë, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar Porti i Durrësit, dhe për autokolonën e dytë, pika e hyrjes është pika e kalimit kufitar Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, në datën 30 tetor 2008, për autokolonën e parë, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit kufitar Porti i Durrësit dhe për autokolonën e dytë, pika e hyrjes është pika e kalimit kufitar Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe,

përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake sllovene, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1389, datë 17.10.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 25 tetor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) trupa.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 26 tetor 2008, të katër autokolonave ushtarake italiane, të përbëra nga:

- Autokolona e parë, 20 (njëzet) automjete e 56 (pesëdhjetë e gjashtë) trupa.
- Autokolona e dytë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete e 34 (tridhjetë e katër) trupa;
- Autokolona e tretë, 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete e 26 (njëzet e gjashtë) trupa;
- Autokolona e katërt, 20 (njëzet) automjete e 41 (dyzet e një) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

4. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

5. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr.1390, datë 17.10.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I I SEGMENTIT RRUGOR VORË-FUSHË-KRUJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Vorë-Fushë-Krujë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerën totale prej 2 511 112 (dy milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekësh, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 270 000 (dyqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera totale e shpronësimit, 2 511 112 (dy milionë e pesëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të fillojë më 20 tetor dhe të përfundojë më 15 dhjetor 2008.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi, pas verifikimeve përkatëse dhe konfirmimit nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RRETHI TIRANË
Bashkia Vorë, komuna Prezë
Fshati Sharke Prezë Ahmetaq

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR VORË-FUSHË KRUJË
Lloji i pasurisë së paluajtshme

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.pas	Sip m^2	Tokë arë	Truall	Vlefta në lekë	Dru frutorë							Vlefta lekë	Vlera totale	Shënim
						Çmim l/m^2	Çmim l/m^2		Kumb.	Arrë	Fik	Pjeshk	Agrume	Hurma	Rrush			
									copë	copë	copë	copë	copë	copë	copë			
1	Hamdi		Mema															
2	Drita	Bajram	Topi	316/6	431	566		243946									243946	Plotësim dokumentacioni
3	Vath	Shaban	Mema	180/25	330	566		186780									186780	Plotësim dokumentacioni
4	Petrit	Avdulla	Halili	293/28	255	507		129285									129285	Plotësim dokumentacioni
5	Sami	Tahir	Asllanaj	292/14	43	507		21801									21801	Plotësim dokumentacioni
6	Dizar	Hamit	Cela	292/13	25	507		12675									12675	Plotësim dokumentacioni
7	Xhavit	Muharrem	Doda	292/12	55	507		27885							5	7500	35385	Plotësim dokumentacioni
8	Qemal	Ali	Kurti	292/17	16	507		8112							3	4500	12612	Plotësim dokumentacioni
9	I paidentifikuar			6/1	304	507		154128									154128	Plotësim dokumentacioni
10	Ahmet	Ibrahim	Doda	162/46	193	507		97851									97851	Plotësim dokumentacioni
11	Sefer	Ahmet	Doda	162/44.1 162/40	184	507		0 93288									0 93288	Plotësim dokumentacioni
12	Kujtim	Ahmet	Doda	162/42	195	507		98865									98865	Plotësim dokumentacioni
13	Jakup		Mezini	176	646	376		242896									242896	Plotësim dokumentacioni
14	Xhevair	Haziz	Zylfa	352/13	100		1477	147700									147700	Plotësim dokumentacioni
15	Halime	Baki	Zylfa	352/5 352/15	150		1477	221550									221550	Plotësim dokumentacioni
16	Hysni	Haziz	Zylfa	352/7	50		1477	73850									73850	Plotësim dokumentacioni
17	Luan	Haziz	Zylfa	352/8	50		1477	73850									73850	Plotësim dokumentacioni
18	Murat	Haziz	Zylfa	352/6	50		1477	73850									73850	Plotësim dokumentacioni
19	Skënder		Cani		400		1477	590800									590800	Proses regjist. jo i konfirmuar
	Shuma							**2499112**								**12000**	**2511112**	

VENDIM
Nr.1392, datë 17.10.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I MBINGRITJES NË RRUGËN VIRUA-GJIROKASTËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i mbingritjes në rrugën Virua-Gjirokastër.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 3 827 (tre mijë e tetëqind e njëzet e shtatë) m^2, tokë truall, me vlerë 70 642 101 (shtatëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë e njëqind e një) lekë, për sipërfaqen 1 245 (një mijë e dyqind e dyzet e pesë) m^2, kullotë, me vlerë 247 755 (dyqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, për objekte, me vlerë 17 977 763 (shtatëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 88 867 619 (tetëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 480 000 (katërqind e tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera totale e shpronësimit, prej 88 867 619 (tetëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet nga buxheti shtesë i vitit 2008, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të fillojë më 20.10.2008 dhe të përfundojë më 30.12. 2008.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"MASA INXHINIERIKE NË ZONËN E VIROIT – HYRJE GJIROKASTËR"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadast.	Nr. pasur.	Truall			Kullotë			Objekte		Vlefta totale lekë	Shënime
						Sip.m²	Çmimi	Vl.(lekë)	Sip.m²	Çmimi	Vl.(lekë)	Lloji	Vl.(lekë)		
1	Spartak	Astrit	Çani	8541	1/37	75	14446	1083450						1083450	Plot. Dokumentacioni
2	Roland	Hasan	Tushe	8541	1/2	19	14446	274474						274474	Plot. Dokumentacioni
3	(B.pro)Kaliopi.Gaqe.Qendro Pilo Papa			8541	2/229	252	14446	3640392						3640392	Plot.Dokumentacioni
4	(B.pro)Kaliopi.Gaqe.Qendro Pilo Papa			8541	2/229	30	11938	358140						358140	Plot.Dokumentacioni
5	Rekor Albania			8541	2/1			0					88959	88959	Plot.Dokumentacioni
6	Novruz	Reuf	Çulli	8541	3/23	220	11938	2626360						2626360	Plot.Dokumentacioni
7	Spiro	Mihal	Lici	8541	3/12A	253	11938	3020314						3020314	Plot.Dokumentacioni
8	Aleksandra	Koço	Shehu	8541	3/30	50	22659	1132950				Dyqan	1936337	3069287	Plot.Dokumentacioni
9	Dallëndyshe	Sulo	Hoxha	8541	4/6	160	22659	3625440				Mur.rreth.	738972	4364412	Plot.Dokumentacioni
10	Apostol		Mosko	8541	4/3	100	22659	2265900				Ren.Ndërt.	104130	2370030	Plot.Dokumentacioni
11	Apostol		Mosko	8541	4/3	76	22659	1722084						1722084	Plot.Dokumentacioni
12	Sefer	Dalan	Lekloti	8541	4/17	140	22659	3172260						3172260	Plot.Dokumentacioni
13	Sefer	Dalan	Lekloti	8541	4/18	102	22659	2311218						2311218	Plot.Dokumentacioni
14	Novruz	Neim	Kasmi	8541	5/9	125	22659	2832375						2832375	Plot.Dokumentacioni
15	Qiriako	Gaqe	Dhima	8541	5/15	180	22659	4078620				Hotel+Bar	15001130	19079750	Plot.Dokumentacioni
16	Arben	Stefan	Gushi	8541	5/13	51	22659	1155609				Kolona	41940	1197549	Plot.Dokumentacioni
17	Vangjel	Vasil	Ksera	8541	5/19	40	22659	906360						906360	Plot.Dokumentacioni
18	Vasil @Kristo Naci, Kosta Sotiri			8541	5/12	93	22659	2107287						2107287	Plot.Dokumentacioni
19	Vasil @Kristo Naci, Kosta Sotiri			8541	5/2	525	22659	11895975						11895975	Plot.Dokumentacioni
20	Jonuz	Mane	Rabi	8541	5/20	225	22659	5098275						5098275	Plot.Dokumentacioni
21	Ziso	Ilia	Kondi	8541	5/25	50	22659	1132950						1132950	Plot.Dokumentacioni
22	Pëllumb	Faslli	Vreka	8541	6/21	47	22659	1064973						1064973	Plot.Dokumentacioni
23	(B.pronësi)Ismail Kasem Kuka			8541	8/56	16	22659	362544						362544	Plot.Dokumentacioni
24	Arjan	Xhevat	Islami	8541	8/11	23	22659	521157						521157	Plot.Dokumentacioni
25	Sofokli	Sokrat	Qirko	8541	8/66	30	22659	679770						679770	Plot.Dokumentacioni
26	Sofokli	Sokrat	Qirko	8541	8/22	100	22659	2265900						2265900	Plot.Dokumentacioni

27	Sofokli	Sokrat	Qirko	8541	8/18	25	22659	566475						566475	Plot.Dokumentacioni
28	Josif	Mihal	Dhima	8541	8/32	28	22659	634452						634452	Plot.Dokumentacioni
29	Rebani	Ali	Boci	8541	9/49	260	11938	3103880						3103880	Plot.Dokumentacioni
30	Metropolia e Shenjtë Gjirokastër			8541	9/50	341	11938	4070858						4070858	Plot.Dokumentacioni
31	Refik	Ismet	Bebeçi	8541	9/52	170	14446	2455820						2455820	Plot.Dokumentacioni
32	Shpëtim	Bajo	Boci	8541	6/11	21	22659	475839				Shkallë	66295	542134	Plot.Dokumentacioni
33	Leandro	Jorgo	Noti	Gerh-Viro	45/20				80	199	15920			15920	Plot.Dokumentacioni
34	Çaush	Shamet	Basho	"	45/21				260	199	51740			51740	Plot.Dokumentacioni
35	Leandro	Jorgo	Noti	"	45/22				180	199	35820			35820	Plot.Dokumentacioni
36	(B.pro.)Leandro Noti,Spiro Muço			"	45/2				550	199	109450			109450	Plot.Dokumentacioni
37	Çajup	Dino	Muhameti	"	64/9				175	199	34825			34825	Plot.Dokumentacioni
	TOTALI					**3827**		**70642101**	**1245**		**247755**		**17977763**	**88867619**	

VENDIM
Nr.1393, datë 17.10.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS SË MESME DHE TË KONVIKTIT, NË QYTETIN E PESHKOPISË, DIBËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shkollës së mesme dhe të konviktit, në qytetin e Peshkopisë, Dibër.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Peshkopisë.
3. Pronari i pasurivsë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 5 500 (pesë mijë e pesëqind) m^2, tokë truall, e vlerësuar me 5 000 (pesë mijë) lekë m^2, në shumën e përgjithshme 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 193 500 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga bashkia e Peshkopisë.
5. Vlera totale e shpronësimit, 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t'u përdorur për shpronësimet.
6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit nëntor 2008.
7. Punimet për ndërtimin e shkollës së mesme dhe të konviktit të fillojnë më 1.6.2009 dhe të përfundojnë brenda datës 31.12.2010.
8. Bashkia e Peshkopisë të bëjë likuidimin e pronarit, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe bashkia e Peshkopisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SHKOLLËS SË MESME DHE KONVIKTIT NË BASHKINË E PESHKOPISË

Pronari	**Z.K**	**Nr. pas.**	**Sip.truall**	**Çmimi truall lek/m^2**	**Vlera e tokës (lekë)**	**Vlera totale e shpronësimit (lekë)**
Asllan Halit Hoxha (Kuçka)	2932	10/27, 10/29	5 500	5 000	27 500 000	27 500 000

Vlera totale e shpronësimit është 27 500 000 (njëzet e shtatë milionë e pesëqind mijë) lekë.

VENDIM
Nr.1395, datë 17.10.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË , TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE "TITAN" SHPK DHE "OSMANI" SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE "BISHNICA 1" DHE "BISHNICA 2"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe bashkimit të shoqërive "Titan" sh.p.k. dhe "Osmani" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve "Bishnica 1" dhe "Bishnica 2", sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1396, datë 17.10.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË , TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË "ATLAS" SHA, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE "HOLTA KABASH" DHE "HOLTA POROÇAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë "Atlas" sh.a., për ndërtimin e hidrocentraleve "Holta Kabash" dhe "Holta Poroçan", sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1398, datë 17.10.2008

PËR FALJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA TË TAKSËS VJETORE TË QARKULLIMIT RRUGOR TË MJETEVE DHE TË TAKSËS SË REGJISTRIMIT TË PËRVITSHËM TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 9, pika 2, të ligjit nr.9986, datë

11.9.2008 “Për faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, detyrimeve të prapambetura të taksës vjetore të qarkullimit rrugor të mjeteve dhe të taksës së regjistrimit të përvitshëm të mjeteve, si dhe të gjobave dhe të kamatëvonesave të papaguara të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore”, me propozimin e Ministrit të Financave, Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtoritë rajonale të shërbimit të transportit rrugor (DRSHTRR) të kryejnë, për mjetet, që nuk janë në qarkullim, veprimet përkatëse të çregjistrimit të përhershëm të mjetit, brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj, kur pronarët e këtyre mjeteve, debitorë për taksën vjetore të qarkullimit rrugor dhe taksën e regjistrimit të përvitshëm, të dorëzojnë:

a) formularin e vetëdeklarimit, për shkatërrimin, bërjen skrap ose eksportimin përfundimtar, jashtë shtetit, të mjetit, sipas modelit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR);

b) certifikatën e pronësisë;

c) lejen e qarkullimit;

ç) targat e mjetit.

2. Në rastet kur pronarët e mjeteve, që nuk janë në qarkullim, nuk disponojnë certifikatën e pronësisë, lejen e qarkullimit, targën, DRSHTRR-të, të bëjnë çregjistrimin e mjetit rrugor, brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj, pasi subjekti të dorëzojë formularin e vetëdeklarimit, sipas modelit të përgatitur nga DPSHTRR-ja, për:

a) shkatërrimin, bërjen skrap ose eksportimin përfundimtar jashtë shtetit të mjetit;

b) mungesën e certifikatës së pronësisë;

c) mungesën e lejes së qarkullimit;

ç) mungesën e targave.

3. Pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në ligj, për kryerjen e veprimeve të çregjistrimit të mjeteve, që nuk janë në qarkullim, DPSHTRR-ja heq nga regjistri aktiv dhe mban në regjistrin pasiv të gjitha mjetet, të cilave nuk u janë kryer kontrollet teknike të detyrueshme në dy vitet e fundit, duke njoftuar dhe pronarët e këtyre mjeteve.

4. Për pronarët e mjeteve, që nuk janë në qarkullim, debitorë për taksën vjetore të qarkullimit rrugor dhe taksën e regjistrimit të përvitshëm, të cilët nuk kryejnë veprimet për çregjistrimin përfundimtar të mjetit, brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj, DRSHTRR-të nuk do të kryejnë asnjë veprim, për mjetet e tjera në pronësi të tyre, deri në kryerjen e plotë të veprimeve të çregjistrimit të mjeteve, që nuk kanë paguar taksat.

5. Pronarët e mjeteve, që janë në qarkullim, debitorë për taksën vjetore të qarkullimit rrugor dhe të taksës së regjistrimit të përvitshëm, të cilët kryejnë veprimet përkatëse të pagesës së detyrimeve, në të gjithë komponentët e tij, të vitit 2008, brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj, nuk do të paguajnë taksat e prapambetura.

6. Pronarët e mjeteve, që janë në qarkullim, që nuk kryejnë veprimet përkatëse të pagesës së detyrimeve të vitit 2008, brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj, të paguajnë të gjitha taksat e prapambetura të mjetit. Gjithashtu, ndaj këtyre pronarëve nuk do të kryhet asnjë veprim nga DRSHTRR-të, për mjetet e tjera në pronësi të tyre, deri në shlyerjen e plotë të taksave të prapambetura.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe DPSHTRR-të të marrin të gjitha masat për informimin e pronarëve të mjeteve, që janë debitorë, për taksën vjetore të qarkullimit rrugor dhe taksën e regjistrimit të përvitshëm, për të kryer, brenda afatit kohor të përcaktuar në ligj, respektivisht, veprimet e nevojshme të çregjistrimit për mjete që nuk qarkullojnë dhe pagesën e taksave të vitit 2008 për mjetet që qarkullojnë.

8. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i Financave dhe Ministri i Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË
Nr.3547/1, datë 3.9.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për pasuritë që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor Rrëshen-Prosek. Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
Drejtoria Juridike
Sektori i shpronësimeve

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS "RRËSHEN-KURBNESH"

Nr.	Pronari			Zona kadast	Nr. pas	Tokë arë			Tokë truall			Objekti vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri			Sip m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë	Sip. m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlera lekë			
		Perlat		2916										
1	Mark	Lazer	Lazeri	2916	111/1	244	255	62220					62220	Konfirmuar nga ZRPP
2	Pjetër	Frrok	Macaj	2916	169/4				300	544	163200	2206000	2369200	I pakonfirmuar
		Prosek		3060										
1	Ndue	Mark	Gjoni	3060	143/64	247	245	60515					60515	Konfirmuar nga ZRPP
2	Preng	Mark	Lleshi	3060	53/2	55.7	245	13646.5					13646.5	Konfirmuar nga ZRPP
		TOTALI				**546.7**		**136381.5**	**300**		**163200**	**2206000**	**2505581.5**	

Vlera totale e këtij shpronësimi është 2 505 582 (dy milionë e pesëqind e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy) lekë.

KËRKESË
Nr.3742/1, datë 17.10.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Laç-Kisha Shënanout". Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët për të cilët në kolonën "shënime" në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 975 520 (nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e njëzet) lekë.

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LAÇ-KISHA E SHËNANOIT

Nr.	Pronari	Zk	Nr. pas.	Lloji i pas.	Sip. m^2	Çmimi lek/m^2	Vlera lekë	Qyteti	Shënime
1	Bashkëpronarë	2364	4/635	Truall	230	2144	493120	Laç	Konfirmuar nga ZRPP
2	Bashkëpronarë	2364	4/641	Truall	225	2144	482400	Laç	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI				**455**		**975520**		

KËRKESË
Nr.6302/1, datë 17.10.2008

PËR SHTESË SHPRONËSIMI PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shtesë shpronësimi për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan – Vlorë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që vlerësimi i pasurisë tokë është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", duke qenë se është kërkesë shtesë për shpronësim, që do të thotë se janë përfshirë sipërfaqe të pashpronësuara me dy vendimet e Këshillit të Ministrave, nr.207, datë 21.2.2008 dhe nr.269, datë 5.3.2008.

Fshati Nartë do të përfshihet në një fazë të dytë shpronësimi.

Për të gjithë pronarët është bërë shënimi "Rikonfirmim ZRPP", për arsye se, me mbarimin e afateve ligjorë të publikimit dhe të paraqitjes së ankesave, do të rikërkohet konfirmim pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier dhe Vlorë.

Pronarët, të cilët preken nga kjo shtesë shpronësimi, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shtesë shpronësimi nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë, pronë private për interes publik").

Vlera totale e kësaj shtese shpronësimi është 52 207 893 (pesëdhjetë e dy milionë e dyqind e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS LEVAN – VLORË

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë arë,

Fshati	PRONAR				Z.Kad	Nr. Pasurisë	ARE			Shenime
	NR	Emri	Atesia	Mbiemri			Sip.m²	Çmimi m²	Vlera /leke	
Levan	1	Lefter	Shefqet	Tushollari	2436	538/24	195	335	65325	Rikonfirmim ZRPP
	2	Ramadan		Mersini	2436	538/19	553	335	185255	Rikonfirmim ZRPP
